

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Supreme e Kosovës – kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Nesrin Lushta, kryetare, Valdete Daka dhe Agim Maliqi, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Bujar Balaj, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të dënuarit S.M., nga fshati B., komuna e Gj., për shkak të veprës penale ndihma në kryerjen e veprës penale të mashtrimit, nga neni 261 par.2 lidhur me nenin 25 të KPK, duke vendosur sipas kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë të mbrojtësit të të dënuarit, avokat Avdullah Ismajli, nga Gjilani, ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore Gjilan, P.nr.1246/2016 datë 5.6.2017 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PA1.nr.854/2017 datë 28.8.2017, në seancën e kolegjit të mbajtur më 8 maj 2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazë kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të të dënuarit S.M., ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore Gjilan, P.nr.1246/2016 datë 5.6.2017 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PA1.nr.854/2017 datë 28.8.2017.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore Gjilan, P.nr.1246/2016 datë 5.6.2017, i dënuari S.M., është shpallur fajtor për shkak të veprës penale ndihma në kryerjen e veprës penale të mashtrimit nga neni 261 par.2 lidhur me nenin 25 të KPK, dhe është gjykuar me dënim me kusht ashtu që i është vërtetuar dënimi me burgimi në kohëzgjatje prej 60 (gjashtëdhjetë) ditëve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i dënuari në afatin e verifikimit prej 2 (dy) viteve, nuk kryen ndonjë vepër të re penale. I dënuari është obliguar që të paguajë shpenzimet e procedurës penale sado që ato të jenë sipas llogarisë së gjykatës si dhe paushallin gjyqësor në shumë prej 50 € e të gjitha këto në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit. I dëmtuari për realizimin e kërkesës pasurore-juridike është udhëzuar në kontest të rregullt civil.

Në procedurën ankimore Gjykata e Apelit të Kosovës me aktgjykimin PA1.nr.854/2017 datë 28.8.2017, ka refuzuar si të pabazuara ankesat e paraqitura ndërsa aktgjykimi i shkallës së parë është vërtetuar.

Kundër këtyre aktgjykimeve kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë ka ushtruar mbrojtësi i të dënuarit, av. Avdullah Ismajli, për shkak të shkeljes së ligjit penal dhe shkeljeve tjera të dispozitave të procedurës penale, shkelje të cilat kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimeve gjyqësore me propozim që aktgjykimi i shkallës së dytë anulohet dhe e njëjta gjykatë të vendos sipas ankesës të ushtruar kundër aktgjykimit të shkallës së parë dhe i dënuari të lirohet nga akuza në mungesë të provave.

Prokurori i Shtetit me parashtresën KMLP.II.nr.16/2018 e datës 6.2.2018, ka propozuar që të refuzohet si e pabazë kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e ushtruar nga mbrojtësi i të dënuarit.

Gjykata Supreme e Kosovës, në seancën e kolegjit pasi shqyrtoi të gjitha shkresat e çështjes në kuptim të dispozitës së nenit 435 par.1 dhe 436 par.1 të KPPK, vlerësoi pretendimet nga kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë dhe konstatoi se:

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e pabazë.

Në kërkesë mbrojtësi i të dënuarit pretendon se aktgjykimet e kundërshtuara janë të përfshira me shkelje të ligjit penal të cilat konsistojnë në faktin se i dënuari është shpallur fajtor për një veprë të cilën nuk e ka kryer sepse kjo nuk është provuar me asnjë provë të administruar. Sa i përket shkeljeve tjera të dispozitave të procedurës penale të cilat kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimeve gjyqësore mbrojtësi i të dënuarit i referohet nenit 126 par.1 pika 1.3 të KPPK, me të cilën dispozitë i bashkëpandehuri nuk ka mundur të dëgjohet në cilësinë e dëshmitarit. Sipas kërkesës pretendohet se i bashkëpandehuri B.S., i cili në procedurën penale ka pranuar fajësinë dhe për të cilin është veçuar procedura, është marrë në pyetje si dëshmitar, dhe aktgjykimi dënues i shkallës së parë kryesisht bazohet në deklaratën e tij, e që paraqet shkelje të nenit 128 par.1 pika 1 të KPPK. Pra, pretendohet se aktgjykimi është bazuar në dëshminë-provën e papranueshme të dëshmitarit i cili nuk ka mundur të merret në pyetje si dëshmitar.

Gjykata Supreme e Kosovës, duke vlerësuar pretendimet e cekura në kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë si dhe duke u bazuar në shkresat e çështjes gjeti se asnjë nga pretendimet nuk qëndrojnë e duke u nisur nga fakti se është e vërtetë se i dënuari B.S., është shpallur fajtor për shkak të veprës penale të mashtrimit nga neni 261 par.2 të KPK, në procedurën penale sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, PP.nr.1815/2012 datë 26.9.2012, ku në të njëjtën procedurë tani i dënuari S.M. ka qenë i akuzuar për veprën penale ndihma në kryerjen e veprës penale të mashtrimit nga neni 261 par.1 lidhur me nenin 25 të KPK. Në këtë procedurë i dënuari B.S., ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën është akuzuar e që vërtetohet nga procesverbali i shqyrtimit gjyqësor P.nr.246/2013 datë 11.5.2016, ndërkaq edhe i dënuari S.M., në të njëjtën seancë ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën është ngarkuar me

aktakuzë dhe është gjykuar. Sipas ankesës ndaj këtij aktgjykimi Gjykata e Apelit të Kosovës me aktgjykimin PA1.nr.904/2016 datë 31.8.2016, ka anuluar aktgjykimin e shkallës së parë vetëm sa i përket të dënuarit S.M., dhe çështjen e ka kthyer në gjykatën e shkallës së parë për rivendosje ndërsa sa i përket të dënuarit B.S., çështja është vërtetuar. Në rishqyrtim në seancën gjyqësore, e sipas procesverbalit P.nr.1214/2016 datë 23.3.2017, në mes të provave të tjera të cilat janë administruar në shqyrtim gjyqësor është ftuar edhe dëshmitari B.S., dhe ka dëshmuar pasi që paraprakisht është njoftuar me të gjitha dispozitat ligjore të cilat i përkasin dëshmitarit. Gjykata e shkallës së parë pas administrimit të provave të propozuara ka marrë aktgjykim me të cilin i dënuari S.M., është shpallur fajtor dhe është gjykuar sikur që është cekur më lartë duke u bazuar jo vetëm në deklaratën e tani dëshmitarit B.S., por edhe në një mori të provave tjera të administruara në shqyrtim gjyqësor. Duhet të theksohet se në këtë procedurë i dënuari B.S. ka qenë i ngarkuar për veprën penale të mashtrimit nga neni 261 par.1 të KPK ndërsa i dënuari S.M. për të njëjtën vepër të kryer në ndihmë, pra këta të dy të dënuar asnjëherë nuk kanë qenë bashkëkryerës të veprës penale.

Sipas dispozitës së nenit 126 par.1 pika 1.3 të KPPK, si dëshmitar nuk mund të merret në pyetje: i bashkëpandehuri deri sa të zbatohet procedura e përbashkët, pra në rastin konkret përveç faktit se i dënuari B.S. nuk ka qenë i bashkëpandehur me S.M., i njëjti ka dëshmuar si dëshmitar në një procedurë tjetër e jo deri sa procedura është zbatuar për të dy të dënuarit, gjë që pretendimin nga kërkesa e bënë të paqëndrueshëm. Po ashtu nuk qëndron as pretendimi se ka shkelje të nenit 128 të KPPK, sepse dëshmia e dëshmitarit është e papranueshme nëse: personi nuk mund të pyetet si dëshmitar, është i liruar nga dëshmia, është fëmijë apo kur dëshmia është marrë me forcë, me kanosje ose me ndonjë mënyrë tjetër të ndaluar e që në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me asnjë nga pikat e potencuara në këtë dispozitë.

Sa i përket pretendimit se është shkelur ligji penal në dëm të të dënuarit kur i njëjti është shpallur fajtor sepse nuk e ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar kjo Gjykatë gjen se që në të dy aktgjykimet janë dhënë të gjitha provat në bazë të të cilave i dënuari është shpallur fajtor e të cilave prova i jep besimin edhe kjo gjykatë.

Nga të gjitha këto që u thanë më lartë e duke u duke u nisur nga fakti se ndaj të dënuarit nuk është shkelur ligji penal dhe nuk ka shkelje tjera të dispozitave të procedurës penale të cilat ndikojnë në ligjshmërinë e vendimeve gjyqësore u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi e konform dispozitës së nenti 437 të KPPK.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË
Pml.nr.25/2018, më 8 maj 2018

Procesmbajtësi,
Bujar Balaj

Kryetare e kolegjit,
Nesrin Lushta